



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 prill 2014

Numri i lëndës: 2013-18

Jovanka, Dragan dhe Milan Vukovic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 prill 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 26 qershor 2013.

II. FAKTET

2. Siç janë parashtruar nga ankuesit, faktet mund të përmbliidhen si më poshtë.
3. Ankuesit posedojnë një ngastër të tokës në komunën e Gjakovës. Në një datë të pasaktësuar, ata janë njoftuar nga një B.D. se prona e tyre i ishte shitur atij dhe pesë personave të tjerë.
4. Në një datë të mëvonshme të pasaktësuar, ankuesit kanë parashtruar një kërkesë për pronësi në Agjencinë Kosovare të Pronës. Më 11 janar 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) ka deklaruar se ankuesit ishin pronarë të pronës në fjalë. KKPK-ja i ka urdhëruar personat që kishin zënë atë pronë ta lironin atë brenda 30 ditëve. Nuk është e qartë nëse është bërë ankesë kundër vendimit të KKPK-së ose nëse ankuesit kanë kërkuar që të lëshohet ndonjë urdhër për dëbim.
5. Më 27 maj 2013, në përgjigje të pyetjes së ankuesve, bashkërenduesi i EULEX-it për të drejtat pronësore i ka këshilluar ata që duhet të raportojnë rastin e tyre tek shefi i zyrës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë në mënyrë që ai të përcaktoj se a duhet të hapet lëndë penale. Ai gjithashtu ka sugjeruar se ankuesit mund të kërkojnë këshillë ligjore se a duhet t'i nisnin procedurat gjyqësore civile për të mbrojtur të drejtat e tyre pronësore.
6. Nuk ka asnjë tregues që ankuesit kanë tentuar të nisnin procedura penale apo civile lidhur me rastin.

III. ANKESAT

7. Ankuesit pohojnë se prona e tyre është përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe kërkojnë që Paneli të konstatojë se ata janë pronarë të ngastrës së tokës në fjalë.

IV. LIGJI

8. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
9. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e

pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.

10. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e gjyqësisë, policisë dhe doganës.
11. Paneli konstaton se nuk është argumentuar e lerë më treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në ndonjë mënyrë në shkelje të të drejtave të ankuesit.
12. Prandaj, këto çështje të ngritura nga ankuesi nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Si pasojë, ato janë jashtë mandatit të Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.
13. Paneli në fund konstaton se ankuesit mund të vazhdojnë ta ndjekin lëndën e tyre para Agjencisë Kosovare të Pronës apo ta ngritin çështjen e të drejtave të tyre pronësore tek autoritetet kompetente të prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit sipas nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese